

# S T A T U T I

## I SHOQERISE "IMTEX LLAKI MANI" SHPK

### I. KRIJIMI, FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA DHE KOHEZGJATJA E SHOQERISE.

#### NENI 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "IMTEX LLAKI MANI" SHPK, eshte themeluar nga z. DHIMITER LLAKMANI, i date- lindjes 1954, banues ne qytetin e Tiranes, rr. Labinoti, pallati 4, shkalla 5, apartamenti 10, i cili ne kete shoqeri eshte "Ortak i Vetem", ne perputhje me ligjin nr.7638 date 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare".

#### NENI 2

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj tregtare ne per- puthje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe ne perputh- je me dispozitat e ketij statuti.

Shoqeria e ka fituar personalitetin e saj juridik nga di- ta e regjistrimit te saj si person juridik.

#### NENI 3

Emertimi i shoqerise eshte "IMTEX LLAKI MANI" SHPK.

#### NENI 4

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj:  
- tregtimin e mallrave brenda vendit dhe te eksport im- portit me shumice e me pakice si, ushqimore e jo ushqimor industriale, tekstile, mallra te konsumit te gjere, vajra lubrifikante, karburante, lend te para e gjysem te perpu- nuara, linja e makineri, pjese kembimi, prodhime elektrik e prodhime elektronike, prodhime elektro shtepiake, kimi- kate e detergent, prodhime bujqesore e produkte blegtora- le, cigare, duhan, kafe, pije alkolike e gjysem alkolike dhe te gjitha mallrat e tjera qe lejohen te tregtohen;

- ne fushen e ndertimit si, ne ndertimin e banesave, hoteleve etj., ne fushen e transportit, ne fushen e industrise, ne fushen e turizmit, ne perpunimin e tregtimin e lendve djegese etj.;
- ne hapjen e lokaleve te ndryshme si, restorante, bar bufe, mini e supermarket, hoteleri, ne hapjen e agjencive doganore, ne hapjen e pikave te karburantit, servise maki nash e lavash, ne hapjen e autoshkollave, etj.;
- duke vepruar si, komisioner, agjent tregtar, ndermjetsues apo perfaqesues i firmave te huaja e vendase, duke si spedicioner dhe duke kryer tranzitim mallrash.
- ne kryerjen e veprimave bankare si, kreditime, konvertime etj.

#### NENI 5

Qendra e shoqeris eshte ne qytetin e Tiranes. Ajo mund te hape filiale ne te gjithë teritorin e Shqiperise. Selia e shoqerise eshte ne, rrugen Muhamet Gjollësha ne parkingun prane Institutit te Fiskultures Tirane. Shoqeria ka vulen e saj ne te cilen eshte i shkruajtur emeri i vote.

#### NENI 6

Kohëzgjatja e shoqerise eshte percaktuar per nje periudhe kohe mbi 10 vjete, duke filluar nga dita e regjistrimit te saj. Kjo periudhe mund te shkurtohet ne rast se shoqeria prishet para kohe.

## II. KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTI, PJESET E KAPITALIT THEMELTAR,

#### NENI 7

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke. Ai

eshte i ndare ne 50 pjese te barabarta, ku secila pjese ka nje vlere prej 2000 leke, te renditura nga numuri 1 deri ne 50, te cilat jane krejtesisht te shlyera. Ortaku i vetem ka te drejten e zmadhimit te kapitalit themeltar te shoqerise nepermjet shtimit te pjeseve te saj.

NENI 8

Shoqeria eshte themeluar nga z. DHIMITER LLAKMANI, i cili ne kete shoqeri eshte ortak i vetem dhe ka derdhur nje kontribut prej 100.000 leke per formimin e kapitalit themeltar te saj.

NENI 9

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie, ne rast ndarjeje pasurore mes bashkeshorteve dhe ndermjet paraardhesve e pasardhesve.

NENI 10

Pjeset e kapitalit themeltar mund tu transferohen edhe personave te trete.

NENI 11

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar gjithmon duhet te vertetohet me Akt Noterial.

III. MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI,

KOMPETENCA DHE KONTROLLI I SHOQERISE.

NENI 12

Ortaku i vetem i shoqerise perballon humbjen e saj deri ne kufirin e vleres se kontributit te tij per formimin e kapitalit themeltar.

NENI 13

Te gjitha vendimet e shoqerise merren nga ortaku i vetem. Vendimet e tij evidencohen ne nje regjister e cila qendron ne seline e shoqerise.

NENI 14

Shoqeria do te administrohet nga administrator, te cilet duhet te jene persona fizik, megjithate ajo mund te administrohet dhe nga ortakun e vetem.

Si administrator i shoqerise eshte caktuar z. JORGO NAUMI. Ne mardhenie me ortakun e vetem, administratori i shoqerise ka te gjitha kompetencat per te kryer veprimet e administrimit ne interes dhe ne emer te shoqerise, nepermjet kompetencave qe i jane percaktuar ne kete statut ose nepermjet kompetencave qe i delegon ortakun e vetem.

NENI 15

Administratori eshte pergjegjes individualisht ose solidarisht sipas rastit, ndaj shoqerise apo te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te dispozitave te ketij statuti apo per faje gjate administrimit te shoqerise.

NENI 16

Disa nga kompetencat qe i jep ky statut administratorit jane:

- te siguroj drejtimin e mire te shoqerise;
- te administroj pasurine e shoqerise duke perfshire dhe mjetet financiare brenda kompetencave te lejuara nga ortakun e vetem;
- te perfaqesoj shoqeriane ne mardhenie me te tretet;
- te perfaqesoj shoqerine para organeve gjyqesore ose autorizone persona te tjere kompetente;
- kryen veprime juridike me te tretet si, nenshkruen kontrata, ben celje te kredive, kryen veprime bankare etj. brenda kompetencave te lejuara nga ortakun e vetem;
- i propozon ortakut te vetem per strukturen e shoqerise;
- i propozon ortakut te vetem per numurin e punonjeseve qe duhet te kete shoqeria;
- i propozon ortakut te vetem drejtimin e ushtrimit te

aktivitetit qe duhet te zhvilloj shoqeria;

- i propozon ortakut te vetem per hapjen e filialeve apo perfaqesive te shoqerise;

- brenda afateve ligjore i paraqet ortakut te vetem bilancin e aktivitetit te shoqerise;

Administratori i shoqerise ka edhe kompetenca te tjera te cilat ortakut i vetem ja delegon atij.

#### NENI 17

Disa nga kompetencat e ortakut te vetem te shprehura ne kete statut jane:

- vendos per shtimin e kapitalit themeltar;

- miratoh programin e veprimtarise se shoqerise;

- ben ndryshime apo shitesa ne statutin e shoqerise;

- emeroh dhe shkarkon administratoret e shoqerise;

- emeroh dhe shkarkon ekspertin kontabel te autorizuar;

- vendos per strukturen e shoqerise dhe numurin e punonjeve qe duhet te kete ajo;

- vendos per hapjen e filialeve dhe te perfaqesive;

- vendos per mbylljen para kohette shoqerise;

- vendos per pagat e punonjesve dhe shperblimet;

Ortakut i vetem ka dhe te gjitha kompetencat e tjera ne ushtrimin e veprimtarise se shoqerise, te cilat nuk jane percaktuar ne kete statut.

Ortakut i vetem ka dhe te gjitha kompetencat qe ushtron asambleja e ortakëve te percaktuara ne shoqerite me me shume se nje ortak te vetem dhe ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi, per shoqerite tregtare.

#### NENI 18

Kontrolli i shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel te autorizuar, i cili emerohet dhe shkarkohet nga ortakut i vetem.

IV. VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE.

NENI 19

Odo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht viti i pare financiar ka filluar ne ditën e regjistrimit si person juridik dhe ka perfunduar me 31 Dhjetor te vitit 1991.

NENI 20

Llogarite vjetore, raportet mbi veprimtarine e vitit financiar dhe raportet e vecanta te pergatitura nga administratori, nga eksperti kontabel i autorizuar, miretohet nga orteku i vetem.

NENI 21

Bilanci vjetor i shoqerise per veprimtarine e kryer nxirret brenda 3 mujorit te pare te vitit pasardhes.

NENI 22

Fitimi netto i realizuar nga shoqeria, pasi sbriten te gjitha shpenzimet, ortaku i vetem vendos per qellimin e perdorimit te tij, si per nxitjen ekonomike te shoqerise, per fonde te vecanta financimi, per fonde sociale, per reklamen tregtare, sponsorizime etj.

NENI 23

Shoqeria i disponon lirisht fitimet e veta ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

NENI 24

Shoqeria ka te drejten e perdorimit e te disponimit te pasurise se saj, ne perputhje me qellimin e objektit te veprimtarise qe kryen.

NENI 25

Shoqeria sic pergjigjet per detyrimet sipas dispozitave ligjore ne fuqi, gezon dhe te gjitha te drejtat dhe mbroj

tjen e saj nga legjislativioni shqiptar ne fuqi.

NENI 26

Detyrimet qe linden shoqerise gjate veprimtarise se saj, ajo i mbulon nga fondi rezerve, nga fondet e tjera ose nga shumet suplementare qe mund te derdh ortakut i vetem.

V. PUNESIMET NE SHOQERI.

NENI 27

Per punonjesit qe do te punesohen, mardheniet juridike midis shoqerise dhe te punesuarve do te rregullohen nepermjet kontrates se punes.

NENI 28

Shoqeria merr persiper te derdh ne kohen e duhur te gjith detyrimet ligjore, dhe per te punesuarit prane saj te derdhe rregullisht kontributet e sigurimeve shoqerore ne pergjindjen e caktuar sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

VI. PRISHJA E SHOQERISE DHE LIKUJDIMI.

NENI 29

Shoqeria priset para kohe kur:

- aktiviteti ekonomik i saj vazhdimisht per nje kohe te gjate eshte me humbje;
- per arsye te percaktuar me ligj;
- ne odo rast tjeter kur ortakut i vetem e shikon te arsyshme mbylljen e saj.

NENI 30

Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e marrjes se vendimit per prishjen e saj.

Per kryerjen e ketij procesi ortakut i vetem cekton nje ose disa likujdues te cilet i paraqesin atij raportin mbi gjendjen e aktivitetit te pasivitetit te shoqerise dhe mbi ndje

kjen e procedurës së operacioneve të likuidimit.

NENI 31

Vetëm mbas pagimit të kreditorëve dhe shlyerjen e të gjitha detyrimeve të ndryshme, likuiduesi i kalon ortakut të vetëm kapitalet e mbetura.

VII. DISPOZITAT E FUNDIT.

NENI 32

Shndërrimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në formë të tjera shoqërie tregtare si anonime etj., kryhet vetëm me vendim të ortakut të vetëm dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për shoqëritë tregtare.

NENI 33


Kër të gjitha mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë, organi kompetent për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Qëdrethit Tiranë.

NENI 34

Ky statut është hartuar në qytetin e Tiranës sot më dt. 10.1.1994.

PER SHOQËRINË "IMPEX LLAKI MANI" SHPK

Dhimitër Llakmani



LLAKI MANI  
IMPORTREGETRANSEXPORT  
TIRANE ALBANIA  
TEL+FAX 35542 32206